

## KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot, më datë 09 Tetor 2020 (dy mijë e njëzet), u paraqitën personalisht palët e mëposhtme, të cilët ranë dakord me hartimin e kësaj Kontrate Shitje si më poshtë vijon:

1. **Behar Cukaj**, i biri i Myslymit, shtetas shqiptar, lindur në Gjinoqar Fier më 12.06.1962, identifikuar me letërnjoftim me nr personal G20612159S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike.

*quajtur këtu më poshtë "Shitësi"*

2. **"Bolv Oil" sh.a**, regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër NIPT: K32528408H, me seli në adresën Patos, Griz Rruga Nacionale Fier- Patos Km.6, Zona Industriale, përfaqësuar nga administratori Z. Agron Bulku, I lindur dhe banues në Tiranë më 23.01.1973, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal H30123114M me zotësi të plotë juridike.

*quajtur këtu më poshtë "Blerësi"*

**Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, pranuan të nënshkruajnë kontratën shitjes së aksioneve sipas kushteve të mëposhtme:**

### MEQËNËSE:

- Albdripping sha, person juridik regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër NIPT: L43512401N, me seli në adresën Fier Patos GRIZ Rruga Nacionale Fier- Patos Km.6, Zona Industriale , Godina e ndodhur ne Zonen Kadastrale 2890 Nr.Pasurie 58/12, Vol 1 Faqe 171.
- Shitësi Behar Cukaj është aksionar i vetëm i shoqërisë dhe zotëron 1000 aksione që i korrespondon 100% të kapitalit të shoqërisë "Albdripping" sh.a, sic dhe rezulton nga dokumentat e shoqërisë.
- Blerësi "Bolv Oil" sha, regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër NIPT: K32528408H, me seli në adresën Patos, Griz Rruga Nacionale Fier-



Patos Km.6, Zona Industriale, ka shprehur interesin për të blerë aksionet, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë.

## **NENI 1**

### **BAZA LIGJORE DHE OBJEKTI**

- 1.1 Kjo Kontrate bazohet në nenet 705 e vijues te Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenin 43 te Ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.
- 1.2 Objekt i kësaj Kontrate është shitja e 1000 aksioneve të zotëruara nga Z. Behar Cukaj në shoqërinë “Albdrilling” që i korrespondojnë 100% e kapitalit të shoqërisë.

## **NENI 2**

### **CMIMI I SHITJES**

- 2.1 Palët kanë rënë dakort që vlera e 1000 aksioneve të zotëruara nga shitësi në shoqërinë “Albdrilling” sha, do të kalojnë në pronësi të blerësit kundrejt vlerës 875,000 ( teteqind e shtatedhjetë e pese mijë ) leke.
- 2.2 Pagesa e cmimit të shitjes në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare në llogarinë e shitësit pranë bankës \_\_\_\_\_

## **NENI 3**

### **MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË**

- 3.1 Me vërtetimin e kryerjes së pagesës së plotë të cmimit të shitjes, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë, shitësi zhvishet nga pronësia e tij mbi aksionet që zotëron në shoqërinë “Albdrilling” sha, dhe blerësi bëhet pronar i vetëm i aksioneve.

## **NENI 4**

### **EFEKTET E KONTRATËS**

- 4.1 Kjo Kontratë krijon efektet e parashikuara në nenin 83 të Kodit Civil, vetëm pas nënshkrimit rregullisht të saj nga palët.
- 4.2 Palët deklarojnë dhe konfirmojnë se kjo kontratë, përbën një akt të detyrueshëm dhe me fuqi të plotë, jo vetëm për to por edhe për të gjithë trashëgimtarët ligjorë, legatarët që mund të përfitojnë në të ardhmen interesa apo të drejta prej saj.

## NENI 5

### TRANSFERIMI I AKSIONEVE

5.1 Shitësi dhe blerësi do të nënshkruajnë dhe dorëzojnë çdo dokument të nevojshëm për transferimin dhe për regjistrimin e këtij transferimi ne regjistrat e Shoqërisë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në Qendrën e Regjistratit të Aksioneve dhe/ose në çdo autoritet apo institucion tjetër sipas ligjeve shqiptare.

## NENI 6

### DEKLARATA DHE GARANCI

6.1 Shitësi deklaron dhe garanton blerësin se:

- a. Aksionet janë të lira nga çdo lloj pengu, detyrimi, e drejteë parablerjeje dhe/ose ndonjë barre tjetër.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga shitësi, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat shitësi është palë.
- c. Shitësi deklaron dhe garanton blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

6.2 Blerësi deklaron dhe garanton se:

- a. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat apo dokumentet e tjera ligjore.
- b. Blerësi deklaron dhe garanton shitësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

## Neni 7

### DISPOZITA TE FUNDIT

7.1 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, duke përjashtuar ne këtë mënyrë çdo pretendim për detyrime të mëtejshme ndërmjet Palëve.

7.2 Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera të mëparshme dhe vlefshmëria e një


kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër të mëparshëm.

7.3 Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

7.4 Çdo konflikt në lidhje me nënshkrimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**SHITËSI**

**Behar Çukaj**



Handwritten signature of Behar Çukaj in blue ink, written over a horizontal line.

**BLERËSI**

**Shoqëria "Bolv Oil" sha**

**Përfaqësuar nga:**

**Administratori**

**Agron Bulku**



Handwritten signature of Agron Bulku in blue ink, written over a horizontal line.

